



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik “Metag Insaat Ticaret Anonim Sirketi & Rahovica Commerce Shpk & FlorinG Shpk” të datës 01.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 24.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës A – pjesa e parë” me nr. të prokurimit 616-22-7096-5-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 104 511, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e grupit të operatorëve ekonomik “Metag Insaat Ticaret Anonim Sirketi & Rahovica Commerce Shpk & FlorinG Shpk” të datës 01.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 24.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugës A – pjesa e parë” me nr. të prokurimit 616-22-7096-5-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 104 511.
- II. AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Metag Insaat Ticaret Anonim Sirketi & Rahovica Commerce Shpk & FlorinG Shpk” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Grupi i operatorëve ekonomik "Metag Insaat Ticaret Anonim Sirketi & Rahovica Commerce Shpk & FlorinG Shpk" (tutje "parashtruesi) me datë 01.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 24.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës A - pjesa e parë" me nr. të prokurimit 616-22-7096-5-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 104 511.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është si në vijim: "AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë një Operator Ekonomik të pa përshtatshëm konform nenit 65 të LPP-së dhe që i bie se ky OE i pa përgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar kërkesat e AK të vendosura në njoftimin për kontratë- NJK dhe në dosje të tenderit - DT... Njëri anëtar i Grupit të Operatorëve të rekomanduar për kontratë më konkretisht "Sallahu" Sh.P.K. është betuar rrejshëm nën betim pasi që i njëjti me aktgjykim të plotëfuqishëm të gjykatës me nr. 94/18 të datës 30.03.2018...".

Për shkak të pretendimit si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 65 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 08.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimit të parashtruesit është gjetur pretendimi është i pabazuar në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të RRPP.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimit të parashtruesit, janë administruar si prova Njoftimi për kontratë, oferta e tenderuesit të rekomanduar, letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit drejtuar tenderuesit të rekomanduar, përgjigja e tenderuesit të rekomanduar në kërkesën për sqarimin e tenderit, raporti i vlerësimit nga komisioni vlerësues, njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues si dhe të gjitha dëshmitë që parashtruesi i ka prezantuar brenda kërkesës për rishqyrtim.

Pas analizimit të pretendimit të parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimin e tij. Rrjedhimisht pretendimi i parashtruesit është i pabazuar pasi që nga provat e administruara është vërtetuar e kundërta e pretendimit sipas elaborimeve në vijim:

- Në lidhje me pretendimin e parashtruesit se tenderuesi i rekomanduar përkatësisht operatori ekonomik "Sallahu Shpk" është i papërgjegjshëm sipas nenit 65 të LPP pasi që përfaqësuesi i saj i autorizuar është dënuar për vepër penale, si i tillë ky pretendim është plotësisht i pabazuar. Fillimisht duhet cekur se në përputhje me nenin 64 të LPP, DT dhe FDT si dhe RRPP, një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të njafuëshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të LPP nuk zbatohen:
- në lidhje me Nenin 65, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të LPP-së, **Deklaratë nën betim e nënshkruar nga Operatori ekonomik në fjalë;**
- b. në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit e themelimit të Operatorit ekonomik;
- c. në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8, për sigurimet sociale, dhe 4.9 të LPP-së, një certifikatë e lëshuar nga autoriteti kompetent ose Operatori publik që dëshmon se një situatë e tillë nuk ekziston;
- d. në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 të LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik.

Tenderuesi i rekomanduar me rastin e dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit ka ofruar deklaratën nën betim të nënshkruar dhe vulosur sipas aneksit të përcaktuar dhe në përputhje me kërkesat në DT dhe FDT. Pas analizimit të dhënave sipas certifikatës së biznesit por edhe të dhënave në ARBK është gjetur se pronar përkatësisht drejtor (përfaqësues i autorizuar) i operatorit ekonomik "Sallahu" Sh.P.K. është Lulzim Sallahu (dhe jo personi N.S. siç pretendon parashtruesi). Për të njëjtin tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar certifikatën e të kaluarës penale me nr. Pn.Nr/Kr.Br 2445/2022 nga Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik **ku evidentohet se i njëjti nuk është i dënuar për vepër penale** dhe ndaj tij nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë penale. Kjo certifikatë e gjykatës kompetente është njafuëshme i pranueshëm për të konfirmuar përshtatshmërinë e operatorit ekonomik në kuptim të nenit 65 të LPP. Megjithatë operatori ekonomik ka dorëzuar edhe certifikatën me nr. Agj.nr 1417-22 nga Gjykata Komerciale në Prishtinë në emër të biznesit "Sallahu" Sh.P.K. me NUI 810135237, certifikatë kjo e lëshuar po ashtu në kuptim të nenit 65 paragrafëve 4.1 deri 4.4 të LPP. Po ashtu është dorëzuar edhe vërtetimi tatimor nga ATK me nr. 1001019880, me të cilin konstatohet se operatori ekonomik nuk ka borxhe të pa shlyera apo obligime të tjera. Mbi bazueshmerinë e dokumentacionit i cili është konform kërkesave në DT, FDT dhe LPP, konstatohet se OE është i përgjegjshëm në kuptim të nenit 65 të LPP dhe në përputhje me deklaratën nën betim. Rrjedhimisht është gjetur se ndaj pronarit dhe drejtorit (përfaqësuesit) të operatorit ekonomik Sallahu" Sh.P.K. - Lulzim Sallahu, nuk ekziston aktgjykim dënues për vepër penale dhe ndaj tij as nuk është duke u zhvilluar vepër penale. Rrjedhimisht pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Sipas elaborimeve më sipër, është gjetur se tenderuesi i rekomanduar i plotëson të gjitha kërkesat nga DT dhe FDT, prandaj ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nga komisioni vlerësues është bërë në harmoni të plotë me dispozitat juridike në fuqi për Prokurim Publik.

Në këtë mënyrë është gjetur se të gjitha pretendimi i parashtruesit është i pabazuar. Rrjedhimisht kërkesa për rishqyrtim e datës 01.03.2023 është refuzuar si e pabazuar në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafit d).

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.03.2023


Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi sipas LPP.